



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË E HUAJ C (3)

Ngarkesa: 6 kredite; 20 seminare; 40 leksione

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program profesional dyvjeçar në "Komunikim shumëgjuhësh në institucione dhe ndërmarrje. "

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të ketë aftësi për një komunikim të mirë me gojë dhe me shkrim në spanjisht. Të ketë aftësi për të kuptuar, interpretuar dhe prodhuar tekste në spanjisht.

Objektivat specifike lëndore:

- Të ketë aftësi për të fituar koncepte bazë të gramatikës, të ortografisë, dhe fjalorit.
- Të ketë aftësi për të komunikuar me dialogje të thjeshta.
- Të ketë aftësi njohuri mbi kulturën dhe traditat e Spanjës.
- Të ketë aftësi për të analizuar, krahasuar dhe nxitur arsyetimin logjik.
- Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.

Rezultatet e pritshme të të nxënit

Në përfundim të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të:

1. Të kuptojë dhe përdorë strukturat themelore gramatikore dhe fjalorin e nevojshëm për komunikimin e përditshëm në gjuhën spanjolle.
2. Të kuptojë informacionin kryesor dhe detajet thelbësore në biseda, dialogë, materiale audio-vizuale dhe tekste të thjeshta mbi tema të njohura.
3. Të komunikojë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në situata të përditshme, duke shprehur mendime, dëshira, sugjerime, përvoja personale, marrëveshje dhe mosmarrëveshje.
4. Të lexojë dhe të kuptojë tekste të thjeshta narrative, përshkruese dhe funksionale, si letra, email-e, njoftime dhe lajme të shkurtra, duke identifikuar informacionin kryesor



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË E HUAJ C (2)**

Ngarkesa: 6 kredite, 20 lex, 40 orë seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I, sem II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar në “Komunikim Shumëgjuhësh në Insitucione dhe Ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat lëndore: Lënda Gjermanisht si gjuhë e huaj (Niveli A1) si gjuha e tretë e huaj synon t’u japë studentëve njohuri bazë gjuhësore dhe aftësi komunikuese. Objektivat e mësimit dhe përmbytjet bazohen në këto tre fusha:

1. Njohuritë:

- a. Studentët përvetësojnë një fjalor elementar që u mundëson të komunikojnë në situata të përditshme. Ata mësojnë fjalor mbi tema si përsëndetjet, familja, blerjet, koha e lirë dhe udhëzimet e thjeshta.
- b. Studentët mësojnë struktura bazë gramatikore, si përdorimi i kohës së tashme, përemrat vetorë, artikujt (të përcaktuar dhe të papërcaktuar), strukturat e thjeshta të fjalive dhe pyetjet.
- c. Ata marrin njohuri të para mbi aspektet kulturore të vendeve gjermanofolëse, gjë që i ndihmon të kryejnë biseda të thjeshta në një kontekst kulturor.

2. Aftësitë:

- a. Studentët duhet të jenë të aftë të lexojnë tekste të shkurtra dhe të thjeshta, si reklama, e-maile të shkurtra dhe mesazhe personale, dhe të kuptojnë përmbytjen e tyre.
- a. Ata zhvillojnë aftësinë për të shkruar tekste të shkurtra dhe të thjeshta, si një kartolinë, një e-mail të thjeshtë ose shënime për tema të përditshme.
- c. Studentët ushtrojnë situata të thjeshta bisedash, ku mund të prezantohen, të bëjnë pyetje dhe të japin përgjigje, të japin udhëzime të thjeshta ose të flasin për tema të përditshme.

3. Kompetencat:

- a. Studentët duhet të jenë në gjendje të komunikojnë në situata të thjeshta dhe rutinë, si prezantimi, pyetja për udhëzime, blerjet ose porositja në një kafene.
- b. Ata mësojnë të njohin dallime kulturore bazë dhe t’i përfshijnë ato në komunikimin e tyre për të qenë më të sigurt në një mjedis gjermanishtfolës.
- c. Studentët duhet të jenë në gjendje të përvetësojnë gjuhën në mënyrë të pavarur, duke lexuar tekste të thjeshta, duke e bërë ushtrime gjuhësore dhe duke monitoruar përparimet e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHE E HUAJ E DYTË C(2)

Ngarkesa: 6 kredite E.C.T.S, 20 orë leksione/40 orë seminare

Viti akademik: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Programi i Studimit Profesional Dyvjecar në “Komunikim shumëgjuhësh në institucione dhe ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore : Të përvetësojë njohuri të elementeve gjuhësore të frëngjishtes në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor duke respektuar specifikat fonetike; të zhvillojë aftësi të analizës, si dhe shumë strategji të të nxëniet që do të çojnë gradualisht drejt autonomisë gjuhësore; Të zhvillojë aftësitë për të zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat për t’u prezantuar, për të folur për veprimtaritë dhe zakonet në jetën reale: Të përvetësojë një metodë pune të pavarur. Të kalojë nga situata e të kuptuarit drejt të të shprehurit. Të përvetësojë kompetenca të të kuptuarit, të lexuarit, të shprehurit me shkrim dhe me gojë. Të zhvillojë aftësitë e vëzhgimit duke marrë njohuri mbi regjistrat e gjuhës.

Objektivat e specifike lëndore:

Lënda synon që studenti :

- Të njohë kompetencat gjuhësore bazë në situata të thjeshta, që lidhen me ambjentin rrethues.
- Të mund të zgjedhë dhe të përdorë fjalë dhe shprehje për t’u prezantuar, për të prezantuar, për të përshkruar situata jetësore të tij : ndjenjat, emocionet, përjetimet e ndryshme në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen.
- Të përvetësojë kompetencat gjuhësore në rrethana të thjeshta.
- Të kuptojë kuptimin bazë të lajmërimeve dhe mesazheve të thjeshta e të qarta.
- Të shprehet thjeshtë, të jetë në gjendje të gjejë informacione në dokumente të thjeshtë.
- Të reagojë në situata të thjeshta komunikimi.